



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 4711 prot.

Tiranë, më 06 04 2024

**Lënda:** Përcillet për njohje dhe zbatim Urdhëri i Rektorit "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Arteve"

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË MUZIKËS**  
Prof. Dr. Isak SHEHU

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA**  
Prof. Artan PEQINI

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK**  
Prof. Ilir MARTINI

Të nderuar,

Bashkëngjitur përcillet për njohje dhe zbatim Urdhri nr. 46, datë 5.04.2024 i Rektorit të Universitetit të Arteve "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Arteve".

Njësitë kryesore të marrin masat e nevojshme në funksion të një procesi të rregullt zgjedhor sipas detyrave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve.

Në zbatim të nenit 6 dhe nenit 37 të Rregullores së sipërpërmendur, të njoftohet i gjithë personeli akademik dhe studentët e secilit fakultet, për kandidimin e tyre për **anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) dhe Komisionit të Apelimit (KA) të UART**, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, në datat **8-9 Prill 2024**. Aplikimet pranohen deri në orën **16:00 të datës 9 Prill 2024**.



Bashkëngjitur modelet e formularëve të vetkandidimit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

  
**Prof. Kastriot ÇAUSHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 471 Prot.

Tiranë, më 05/04/2024

URDHËR

Nr. 46, Datë 05/04/2024

MBI

**“SHPALLJEN E DITËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E PËRCAKTUAR NGA MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Mbështetur në nenin 36, pika 7 dhe nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, në Urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, në nenin 22, pika 6 si dhe në nenin 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Arteve është data 21 Maj 2024.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Arteve është data 21 Qershor 2024.
3. Ky urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim, të gjitha njësive kryesore dhe njësive të tjera në përbërje të Universitetit të Arteve.
4. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Kastriot CAUSHI